

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E MBROJTJES ME OBJEKT
“MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE”,
PËR PERIUDHËN 16.09.2013 - 31.12.2014.**

Raporti Përfundimtar i Auditimit i ushtruar në Ministrinë e Mbrojtjes, me objekt “Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën 16.09.2013 deri 31.12.2014, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së Nr. 134, datë 30.09.2015. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën nr. 125/34, datë 30.09.2015, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar znj. Mimi Kodheli, Ministër i Mbrojtjes, ku janë rekomanduar dhe kërkuar zbatimi i masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Nga auditimi mbi planifikimin e buxhetit të mbrojtjes, planifikimi i zërave të shpenzimeve është bazuar dhe në kërkesat e Dokumentit të Rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes në Republikën e Shqipërisë, ku përcaktohet se raporti i shpenzimeve të jetë 35% për shpenzimet e personelit, 35% për operacionet dhe mirëmbajtjen dhe 30% për investimet, ndërsa referuar standardeve të NATO-s buxheti i mbrojtjes duhet të zërë 2% e PPB, por në asnjë nga periudhat e audituara, si në planifikim dhe në realizim nuk janë arritur raportet e shpenzimeve sipas Strategjisë së Mbrojtjes apo të standardeve të NATO-s.

Për këtë është rekomanduar:

Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, të marrin masa që në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të përcaktojnë e monitorojnë saktë prioritetet e mbrojtjes në përputhje me Dokumentit të Rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes në Republikën e Shqipërisë, dhe referuar standardeve ***si vend anëtar i NATO-s buxheti i mbrojtjes duhet të planifikohet në masën 2% të PBB-së.***

Menjëherë

2. Nga auditimi i realizimit të buxhetit të vitit 2014, u konstatua se është cenuar parimi kryesor i realizimit të buxhetit, ai i anualitetit, pasi nëpërmjet përdorimit të Letër Kredive janë raportuar si të realizuara rreth 50 për qind e fondeve të planifikuara për investime nga MM, ose njësitë e varësisë, ndërkohë që ato janë kryer/likuiduar pas vitit 2014.

2.1. Nga auditimi mbi zbatimin e buxhetit u konstatua se, për zbatimin e projekteve në investime për blerje mjete ushtarake, armatim e municion, për të cilat janë bërë dhe ndryshimet në planin vjetor, janë përdorur në fund të vitit 2014 *pagesa me Letër Kredit, në shtatë raste, gjithsej për shumën 1.507,701,460 lekë, duke likuiduar nga 75% deri në 100% të kontratave të lidhura.*

- Në katër raste është lidhur kontrata pa marrë më parë miratimin e Ministrit të Financave, ndërsa në një rast është kryer pagesa për të gjithë vlerën e kontratës, ndërkohë që Ministri i Financave ka miratuar pagesën me L/C për 90% të vlerës, veprime në kundërshtim me Udhëzimin Standard të Zbatimit të Buxhetit nr. 2, datë 06.02.2012, i ndryshuar pika 147.

- Për kryerjen e pagesave me Letër Kredit nga institucioni janë përballuar komisione në shumën 2,753,805 lekë.

- Në pesë raste, në shumën 2,175,202,996 lekë është përdorur “Depozita e Qeverisë” me miratim të Ministrit të Financave.
- Nga përdorimi i kurseve preferenciale të bankave të nivelit të dytë në veprimet në valutë, është konstatuar një efekt negativ financiar në shumën 4,110,451 lekë.

2.2. Me VKM nr. 326, datë 28.05.2014 “Për njohjen dhe shlyerjen e detyrimit të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë kundrejt Drejtorisë së Përgjithshme të Armatimit në Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Francës(DGA), për kontrollin teknik të kryer gjatë procesit të pranimit të tri helikopterëve Cougar AS532AL”, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes janë miratuar shpenzimet për kontrollin teknik të kryer nga kjo Drejtori, për tre helikopterë që kanë mbërritur e janë gjendje në Forcat e Armatosura në periudhën viti 2012-2013, në shumën 180,000 Euro, ose me një tarifë prej 60,000 Euro për një helikopter, pra janë njohur shpenzime pas faktit. Bashkëlidhur kësaj praktike është vetëm relacioni, pa pasur një marrëveshje të mëparshme dhe një përshkrim analitik të elementëve të këtyre shpenzimeve.

Këto fonde por dhe tarifa për një helikopter i ardhur në vitin 2014, gjithsej në shumën 240,000 Euro, ose 33,456,000 lekë, janë përballuar nga fondet e miratuara për Komandën e Forcës Ajrore, në programin buxhetor “Forcat e Luftimit”, artikulli 231 “Shpenzimet Kapitale” ku bashkëlidhur pagesës së njësish janë faturat e lëshuara nga DGA dhe raportet e punës të paraqitura nga kontraktori.

Për këtë është rekomanduar:

- Të eliminohen praktika të tilla (Letër Kredi) në realizimin e shpenzimeve buxhetore, sidomos në fund të vitit. Në raste të veçanta (të përcaktuara qartësisht me akte normative), të ketë formate ku specifikohen qartë kushtet e përdorimit të LC, në veçanti për masën e komisioneve dhe mënyrën e pagesës së tyre, pasi të sigurohet dakordësia me Ministrinë e Financave. Rekomandojmë me forcë që në këtë proces të përcaktimit të marrëveshjeve dhe kushteve të tyre, të sigurohet që strukturat drejtuese të bashkëpunojnë me Ministrinë e Financave dhe domosdoshmërisht me Bankën e Shqipërisë.
- Të nxirret përgjegjësia institucionale për raportimin e buxhetit në kundërshtim me rregullat dhe parimet bazë buxhetore, lidhur me deklarin e investimeve/shpenzimeve të pa kryera si të realizuara.

Menjëherë

3. Me Aktin Normativ nr. 2, datë 29.12.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 185/2013, datë 28.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014” të ndryshuar, Ministrisë së Mbrojtjes i janë bërë ndryshime në planin e buxhetit për shpenzimet kapitale.

Ministria e Financës me shkresë nr. 18431/51, datë 23.01.2015, sqaron se ... mbështetur në të dhënat e SIFQ pakësimi prej 12,176 mijë lekë në programin 02120, i miratuar në shkresat tuaja, nuk është realizuar tërësisht për arsye të mungesës së fondeve në këtë program”, për shkak të daljes me vonës të Aktit Normativ dhe shkresave që e shoqërojnë atë, ndërkohë që veprimet janë kaluar në sistemin e pagesave, duke bërë që në këtë program të jenë kryer shpenzime mbi planin gjithsej në shumën 46,339 mijë lekë, në kundërshtim me nenin 40 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe paragrafin 59 të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit”.

Për këtë është rekomanduar:

-Ministria e Mbrojtjes të bashkëpunojë me Ministrinë e Financës, për ndryshimet gjatë vitit në zërat buxhetorë, për zbatimin/monitorimin rigoroz të tyre pasi fondet e miratuara për njësitë e qeverisjes qendrore në ligjin e buxhetit vjetor përbëjnë kufirin maksimal të shpenzimeve, brenda të cilit Këshilli i Ministrave është i autorizuar të marrë përsipër angazhime dhe të kryejë shpenzime. Këshilli i Ministrave e ushtron këtë autoritet i përfaqësuar nga Ministri i Financave.

Në vijimësi

4. Nga auditimi mbi ankandet publike të zhvilluara në Ministrinë e Mbrojtjes, u konstatua se nuk ka është mbajtur regjistri i ankandeve publike, si dhe nuk është ngritur njësia e ankandeve brenda kësaj strukture, në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik” i ndryshuar.

Për këtë është rekomanduar:

Ministria e Mbrojtjes, në cilësinë e Autoritetit Shitës, të plotësojë regjistrin e ankandeve publike, si dhe të krijojë sipas nevojave njësien e ankandeve, në zbatim të ligji nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik” i ndryshuar.

Në vijimësi

5. Në procedurat e prokurimit me objekt “Blerje pakete armatimi nga C...’S,”; “Blerje armatimi nga B...S.P.A, I...”; “Blerje paketë armatimi nga H... & K..., Gj....”; “Blerje municioni nga F.....M....S.P.A, I....” dhe “Blerje mjete të blinduara për policinë ushtarake me kompaninë I..... s.p.a I....”, Autoriteti Kontraktor:

5.1.Ka llogaritur vetëm vlerën e projektit (mallit), në kundërshtim me “Rregulloren për procedurat që përdoren nga Ministria e Mbrojtjes për prokurimin e disa mallrave dhe shërbime të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik” Kreu III, pika 2/a, duke mos dhënë një tablo të qartë mbi vlerat e shpenzuara deri në fund të ekzekutimit të kontratave.

Ministria e Mbrojtjes, në raportimin e fund vitit pranë Këshillit të Ministrave, nuk jep vlerën gjithsej për realizimin e projekteve ushtarake, në të cilën të jenë përfshirë shpenzimet e transportit, taksat doganore, TVSH, taksat dhe detyrimet të tjera që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar.

Për këtë është rekomanduar:

Ministria e Mbrojtjes, në cilësinë e Autoritet Kontraktor të marrë masat e nevojshme për zbatimin saktësisht të rregullave për procedurat që përdoren nga Ministria e Mbrojtjes për prokurimin e disa mallrave dhe shërbime të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik, me qëllim evidentimin e saktë dhe transparent të përdorimit të fondeve publike në procedurat prokuruese për qëllime ushtarake.

Në vijimësi

5.2. Në përlllogaritjen e vlerës së kontratës, nuk është zbatuar “Rregullorja për procedurat që përdoren nga Ministria e Mbrojtjes për prokurimin e disa mallrave dhe shërbime të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik” Kreu III pika 2/c, por janë mbështetur në dokumentin “Kërkesë për çmim dhe disponueshmëri” që ju ka ardhur nga kompanitë prodhuese ushtarake. Vlera e kontratës nuk është paraqitur e detajuar, por është paraqitur në vlerë totale, e paargumentuar për çdo element të ofertës, duke e kompromentuar procesin tenderues në segmente të ndryshme.

Për këtë është rekomanduar:

Autoriteti Kontraktor të zbatojë rregullat për procedurat që përdoren nga Ministria e Mbrojtjes për prokurimin e disa mallrave dhe shërbime të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik si dhe të paraqitet në mënyrë të detajuar çdo element i vlerës së kontratës ushtarake.

Në vijimësi

5.3. Në procedura janë përfshirë persona që marrin pjesë në dy hapa të procesit, në kundërshtim me “Rregulloren për procedurat që përdoren nga Ministria e Mbrojtjes për prokurimin e disa mallrave dhe shërbime të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik” Kreu V, pika 1/a dhe b.

Për këtë është rekomanduar:

Autoriteti Kontraktor të zbatojë saktësisht rregullat për procedurat që përdoren nga Ministria e Mbrojtjes për prokurimin e disa mallrave dhe shërbimeve të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik.

Në vijimësi

5.4. Ka kërkesa operationale të gjeneruara nga strukturat ushtarake përkatëse, të cilat kanë pësuar ndryshime gjatë procesit të prokurimit të imponuara nga vërejtjet e ardhura nga operatorët ekonomikë prodhues ndërkombëtarë, për shkak të kërkesave të pa plota, jo kompetente të njësive ushtarake, të cilat janë miratuar në çdo kohë edhe gjatë procesit të prokurimit, në kundërshtim me VKM. nr. 1403 datë 27.10.2008.

Për këtë është rekomanduar:

Autoriteti Kontraktor, në respekt të detyrave funksionale dhe si vend anëtar i NATO-s, të krijojë stafin e nevojshëm/përshtatshëm me qëllim shmangien e treguesve/parametrave të pasaktë, hartimin dhe koordinimin optimal të tyre, në zbatim të kërkesave të parashikuara nga VKM. nr. 1403 datë 27.10.2008.

Në vijimësi

5.5. Ministria e Mbrojtjes, për periudhën objekt auditimi, nuk ka dërguar përfaqësues në komisionet e vlerësimit të privatizimit, duke sjellë pezullimin e procesit, me arsyetimin se: *ka nisur verifikimi dhe auditimi i brendshëm i procedurave të ndjekura të privatizimeve të pronave jashtë Planit të Përhapjes në administrim të MM; ka ndodhur ristrukturimi i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë; ka pasur mangësi nga SHPFA duke vendosur prona që nuk janë në administrim të MM etj.*

Për këtë është rekomanduar:

Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura (SHPFA), të mos pezullojë procesin e vlerësimit të privatizimit, por të bëjë saktësimin e listës së pronave të lira, pronave që duhet të rifuten në planin e përhapjes si dhe pronave që duhet të jenë të lira, të cilat kanë humbur funksionin e tyre, përditësimin e të dhënave me të gjithë komponentët e sistemit të privatizimit, në bashkëpunim me institucione të tjera shtetërore si Zyrën e Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencinë e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave Ndërtimore Informale.

Në vijimësi

6. Mbi detyrimet ndaj të tretëve.

6.1. Referuar Raportit të kompanisë së auditimit “D.....”, konstatohet se për Ministrinë e Mbrojtjes janë raportuar detyrime me vlerë 575,901,330 lekë, të cilat përbëjnë 2.34 për qind të borxhit gjithsej të qeverisë, ndërsa ministria në oponencë të këtij raporti ka paraqitur një borxh me vlerë 1,515,513,396 lekë gati tre herë më të lartë deri më 31.12.2013.

Kjo shumë ka ardhur duke u rritur deri në raportimin përfundimtar në janar 2015, ku vlera e raportuar e borxhit ka arritur në shumën 1,929,019,878 lekë, të cilat 243,840,093 lekë janë përballuar nga fondet e veta dhe 1,580,417,197 lekë janë çelur nga Fondi i Kontigjencës, nga të cilat janë ekzekutuar 1,357,499,197 lekë.

6.2. Nga raportimet e Ministrisë së Mbrojtjes konstatohet se janë evidentuar si detyrime të prapambetura gjendje më 31.12.2013, për “*furnitorë për punë dhe mallra*” në vlerën 1,929,019,878 lekë gjithsej, nga të cilat 671,594,209 lekë, ose 35% e totalit të detyrimeve të raportuara si “*borxh*” i korrespondon detyrimeve, për të cilat fatura është lëshuar nga data 1-31.12.2013.

6.3. Nga auditimi rezultoi se në pasqyrat financiare të vitit 2013 nuk janë paraqitur të gjitha detyrimet e krijuara, kryesisht për efekt të mos derdhjes të detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore dhe tatimeve, për pjesën që kontribuon punëmarrësi.

6.4. Nga auditimi i veprimeve të çeljes së fondeve dhe likuidimit të detyrimeve konstatohet se në Ministrinë e Mbrojtjes, nga Drejtoria e Financës, nuk disponohet dokumentacioni justifikues/vërtetues i kryerjes së shpenzimit si kontratë, faturë, akt marrje në dorëzim, etj, por këto dokumente janë në secilën nga njësitë e varësisë, në kundërshtim me pikën 21 të UMF nr. 5, datë 27.02.2014 “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*”, në të cilën është përcaktuar se ... *Nëpunësit Autorizues të njësive qendrore e vendore sigurohen që të gjitha urdhrat e pagesës të paraqitura në degën e thesarit respektiv, të jenë të shoqëruar me dokumentacionin e plotë justifikues, si dhe pikën 26 të UMF nr. 29, datë 24.12.2013 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2013”, dhe përcaktimet e VKM nr. 50, datë 05.2.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimt”.*

Për këtë është rekomanduar:

Ministria e Mbrojtjes, të marrë masat e nevojshme që në të ardhmen të pasqyrojë në evidencën kontabile të gjitha detyrimet, sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Të plotësojë dokumentacionin e duhur për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, konform kërkesave të strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të Udhëzimit të Ministrit të Financave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Në vijimësi

7.1 Llogaritë e Klasës IV “*Kërkesa arkëtimi mbi debitorët*” pasqyrohen në fund të dy periudhave ushtrimore me pasaktësi:

- Në aktivin e pasqyrës financiare të vitit 2014 janë shtuar në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, detyrime në shumën 335,342,515 lekë, të cilat janë detyrime nga dëmtimet e vitit 1997 në Komandën e Forcës Tokësore. Këto detyrime nuk janë pasqyruar bilancin e vitit 2013, pavarësisht se janë detyrime të trashëguara deri në vitin 2012.

- Në aktivin e bilancit të vitit 2014, llogaria 49 “*Shuma të parashikuara për zhvlerësim*” është pasqyruar me gjendje, si në mbyllje të viteve ushtrimore 2013 dhe 2014, konkretisht në

shumën 588,861,147 lekë dhe 196,950,948 lekë, të cilat rezultojnë të jenë detyrime për dëmtimet e vitit 1997, por nga njësitë e varësisë janë pasqyruar gabimisht në këtë llogari.

7.2. Të dhënat e formatit nr. 5 “*Pasqyrë e lëvizjes së fondeve në CASH*” për të dy vitet nuk rakordojnë me të dhënat e fondeve buxhetore, si për planin me ndryshimet, ashtu dhe për shpenzimet faktike, krahasuar këto me të dhënat e sistemit të thesarit për të dy vitet.

7.3. Të dhënat e formatit nr. 6 “*Gjendja dhe ndryshimet e Aktiveve të Qëndrueshme*” të pasqyrës financiare të vitit 2014, kanë pasaktësi dhe nuk paraqesin me vërtetësi ndryshimet e aktiveve gjatë vitit ushtrimor.

Në kolonën 7, “*Shitje*” paraqitet në total shuma 164,520,061 lekë, ndërsa nga auditimi rezulton se në fakt kjo shumë përbëhet kryesisht nga transferimet e aktiveve ndërmjet njësive. Nga auditimi i pasqyrave financiare të Komandës Mbështetëse dhe shpjegimeve të kësaj njësie, konstatohet se janë paraqitur në këtë kolonë shumën 4,312,830 lekë, por që realisht shitjet janë në vlerën 75.600 lekë, ndërsa diferenca për vlerën 4,237,230 lekë është kalim kapital një objekti.

Nga auditimi i pasqyrës financiare të njësisë ASNI, konstatohet se në këtë kolonë ka paraqitur shumën 160,207,231 lekë, të cilat në fakt janë lëvizje dhe sisteme të brendshme.

Në kolonën 8, “*Nxjerrje jashtë përdorimit*” pasqyrohen në shumën 4,927,728,754 lekë, por edhe në këtë kolonë janë përfshirë veprime të lëvizjes brenda aktiveve, konkretisht nga auditimi i pasqyrave financiare të Komandës së Forcës Tokësore rezulton se në bilanc ka pasqyruar shumën 334,910,883 lekë si nxjerrje jashtë përdorimit, ndërsa në fakt janë nxjerrje realisht jashtë përdorimit asete në shumën 11,153,735 lekë, ose me një diferencë të theksuar prej 323,757,148 lekë.

7.4. Nga të dhënat e pasqyrave financiare vërehet se vlera e armatimit, helikopterëve dhe automjeteve të blinduara, të blerë me fonde të buxhetit të shtetit, *nuk pasqyrohen në evidencën kontabile të njësive dhe as në bilancin përmbledhës të Ministrisë*. Këto aktive, pasi janë bërë hyrje nga njësitë përkatëse, i janë bërë dalje specialistit të armatimit, i cili mban llogarinë e armatim-municionit, si një llogari e veçantë nga shërbimet e tjera. Veprimet kryhen, duke ju referuar Rregullores së shërbimit të armatim-municionit, botim i vitit 1990, ku regjistrimi dhe mbajtja e armatim-municionit është klasifikuar sekret. Sipas informacioneve rezultojnë se, armatimi i vjetër mbahet vetëm në sasi, por jo në vlerë, duke mos pasur një vlerë reale të armatimit në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin*”, i ndryshuar, VKM nr. 248, datë 10.04.1998 i ndryshuar, UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “*Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj*” i ndryshuar etj.

Për këtë është rekomanduar:

-Ministria e Mbrojtjes, të marrë masat e nevojshme që në të ardhmen të pasqyrojë në evidencën kontabile të gjitha detyrimet, sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

-Ministria e Mbrojtjes, të marrë masat e nevojshme që të plotësojë dokumentacionin e duhur për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, konform kërkesave të strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura sipas Udhëzimit të Ministrit të Financave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Menjëherë

8. Nga auditimi mbi inventarizimin e pronës shtetërore dhe regjistrimit në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme u konstatua se:

- *Lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore*, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes nuk është azhurnuar me pronat, truallin dhe objektet, si dhe me të dhënat tekniko-ligjore të tyre, megjithëse ato kanë ndryshuar përgjegjësinë e administrimit, brenda dhe jashtë sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes.

Ka prona të pa përfshira në inventarët kontabël të njësive; ka prona të cilat nuk pasqyrohen me vlerë, disa prona edhe pse janë të regjistruara në ZRPP dhe janë përfshirë në evidencën kontabile, në këtë të fundit nuk pasqyrohet me vlerën reale sipas zonave kadastrale, konstatohet se ka mbivendosje të pronave, por ka dhe prona që janë në inventarë të dy njësive.

- Sipas regjistrimit të pronave të dy njësive (*Forca Tokësore dhe Forca Ajrore*), ka të dhëna të ndryshme të pronave, përse i përket sipërfaqeve të tyre, duke krahasuar të dhënat sipas VKM nr. 515, datë 18.07.2003, i ndryshuar, matjeve të kryera nga Instituti i Gjeografisë Ushtarake, por dhe referuar certifikatës së pronësisë.

- Njësia publike, deri në këto momente të auditimit nuk ka një regjistër të aseteve në tërësi, si dhe regjistër të pronave, edhe pse në këtë institucion ka funksionuar projekti CUBIC, nëpërmjet të cilit duhet të evidentoheshin të gjitha pronat në administrim të MM, më të gjithë komponentët e tyre, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

Për këtë është rekomanduar:

Ministria e Mbrojtjes, të marrë masat e nevojshme që në të ardhmen të pasqyrojë në evidencën kontabile të gjitha asetet në administrim të institucionit, si dhe të bëjë regjistrimin e tyre në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, konform kërkesave të legjislacionit për kontabilitetin, atë të regjistrimit të pronave, si dhe menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI.

I. Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “*Kodi i Procedurës administrative*” pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kapitulli IV “*Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve*” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (*Nëpunësi Autorizues*), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit, në vlerën **859,794 euro** si më poshtë:

1. Për Kompaninë “**E.....**” në vlerën **639,794 euro** për shkak se gjatë zbatimit të kontratës së tenderit me objekt “*Furnizimi me 5 helikopterë të mesëm shumërolësh*” e ndryshuar, kompanisë fituese i janë likuiduar katër kite me vlerë 3,458,142 euro, ndërkohë që vlera e katër kiteve sipas dokumentacionit të bërë hyrje është në 2,764,348 euro, ose 639,794 euro më pak.

2. Për Z. **Ë. Ç**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme së Standarteve të NATO-s dhe Modernizimit, z. **A. Sh**, me detyrë Shef i Sektorit të Hartimit të Projekteve, në cilësinë e kryetarit të grupit të punës për hartimin e projektit teknik dhe anëtarët e grupit të punës z. **N.G z. E. D, z. M. K, z. B. D dhe z. B. B** në vlerën **220,000 Euro**, ose nga 31,429

euro/secili, për shkak se në procedurën e tenderit me objekt *“Blerje mjete të blinduara për policinë ushtarake”* me fituese kompaninë *“I...” s.p.a I...*, kanë rritur në mënyrë të pajustificuar, padrejtësisht, fondin limit nga 1,200,000 Euro të parashikuar në projektin fillestar të propozuar nga Komanda e Policisë Ushtarake, në 1,420,000 Euro.

Menjëherë

II. Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”* neni 15, pika b, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 *“Kodi i Procedurës administrative”* pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, Kapitulli IV *“Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve”* pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit, në vlerën **11,491,593** lekë si më poshtë:

1. Për operatorin *“I... T..”* sh.p.k. në vlerën **2,482,217 lekë**, për shkak se në tenderin me objekt *“Blerje furnizim, instalim, vënia në punë e SIVHD ...”* *“Kontrata fillestare”* me fond limit 63,019,515 lekë, ka vonuar zbatimin/dorëzimin e punimeve në kundërshtim me:

- Seksionin II.3.1, të DST, në të cilën afati për kryerjen e punimeve për *“Pjesën e parë”* me fond limit 48,541,515 lekë, është përcaktuar 45 ditë kalendarike.

- pikën 1.5. *“Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër”* të *“Marrëveshje kuadër”* nr. 540/2, datë 18.12.2013 pjesa e parë, në të cilën afati i përfundimit të kontratës është përcaktuar 45 ditë kalendarike nga dita e lidhjes së marrëveshjes kuadër.

- nenin 10 *“Kushtet e dorëzimit”* të kontratës nr. 382/4 datë 30.12.2013 lidhur midis palëve, në të cilin është përcaktuar se ... *furnizuesi do të fillojë furnizimin ... menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe do të përfundojë brenda 45 ditëve kalendarike.*

2. Për komisionin e pritjes së mallit të përbërë nga Major **A. Z**, kryetar, **R. R**, Kapiten **K. T**, Kapter **H. B** dhe **F. Ç** përgjegjës materiali, në cilësinë e anëtarëve, të Repartit Ushtarak nr. 2002 dhe njësisë së prokurimit të përbërë nga **G. J**, **E. F**, **R. R** në vlerën **2,079,096 lekë**, e cila përfaqëson diferencën midis ofertës së OE *“A... Co”* sh.p.k. të shpallur fitues dhe *“B...”* sh.p.k. të skualifikuar në tenderin me objekt *“Blerje materiale për flotën luftarake”*, për shkak se Komisioni i pritjes së mallit ka pranuar dhe marrë në dorëzim pjesët e ndërrimit objekt tenderi, të pa shoqëruar me certifikatë origjine, cilësie dhe fletë garancie. Artikujt e furnizuar nuk janë në përputhje me të dhënat e kërkuara në katalogët dhe skedën teknike, që OE fitues ka paraqitur në ofertë, në kundërshtim me:

- paragrafin e tretë nga fundi i KVK të miratuar me DST, në të cilin është përcaktuar se ... *OE që kualifikohen në këtë procedurë duhet të paraqesin një deklaratë ku të deklarojnë se në momentin e dorëzimit të mallit do ta shoqërojnë atë me certifikatën e cilësisë, certifikatën e origjinës së mallit dhe fletën e garancisë për mallrat e kërkuara.*

- pikën 2.3.3. germa b dhe c të KVK, në të cilat është përcaktuar se ... *Produkti me specifikimet të dhëna nga AK në DST duhet të jetë i përfshirë në përmbajtje të katalogëve ose prospekteve teknike të mësipërm. Për çdo ofertues është e domosdoshme të plotësohet skeda teknike e materialeve. Mos paraqitja e katalogëve ose prospekteve nën autoritetin e prodhuesit si dhe mosparaqitja e të dhënave të kërkuara në katalogët dhe në skedën teknike është kusht kualifikues.* OE *“A... Co”* sh.p.k. nuk i ka shoqëruar artikujt e furnizuar me dokumentacionin e kërkuar.

Njësia e prokurimit është bashkë përgjegjëse për parregullsitë e konstatuara pasi, në dokumentacionin e dërguar Repartit Ushtarak nr. 2002 në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, nuk i ka dërguar KVK me qëllim që *“Komisioni i pritjes së mallit ...”* të bënte krahasimin me sa është përcaktuar në KVK.

3. Për operatorin “**I... T..**” sh.p.k. në vlerën **1,704,258 lekë**, për shkak se në tenderin me objekt “*Blerje furnizim, instalim, vënia në punë e SIVHD ...*” “*Kontrata shtesë*” ka rritur çmimet e tre artikujve të furnizuar/instaluar, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 35/1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, e cila përcakton se ... *Kur lidhen kontrata, të bazuara në një marrëveshje kuadër, palët nuk munden, në asnjë rrethanë, të bëjnë ndryshime thelbësore të kushteve të parashtruara në marrëveshjen kuadër ...* dhe vet “*Marrëveshjen kuadër*” nr. 540/2, datë 18.12.2013 lidhur midis MM dhe dy OE “**I... T..**” sh.p.k. dhe “**A... communication**” sh.p.k.

4. Për punonjësit, N/kolonel **I. D**me detyrë specialist infrastrukture dhe N/kolonel **H.G** me detyrë shëf i Degës së Logjistikës në Repartin Ushtarak nr. 4010, në cilësinë e hartuesve të preventivit dhe fondit limit, në vlerën **1,304,000 lekë**, ose nga 652,000 lekë secili, për shkak se në tenderin me objekt “*Mirëmbajtje kazermash*” në preventivin e llogaritjes së fondit limit, disa nga çmimet e vendosura janë në kundërshtim me “*Listën e materialeve ... për mirëmbajtje kazermash*” të unifikuar (manual) nga Instituti i Studimeve dhe Projektmeve të Mbrojtjes (ISPMb).

5. Për anëtarët e KVO të përbërë nga **M. R, M. O** dhe **E. T** në vlerën **1,113,918 lekë**, ose nga 371,306 lekë secili, e cila përfaqëson diferencën midis ofertës të OE “**S.... Co**” sh.p.k. të skualifikuar padrejtësisht dhe “**Sh....**” sh.p.k. të shpallur fitues, në tenderin me objekt “*blerje artikuj ushqimorë*” loti V “*blerje fruta perime*”, në kundërshtim me pikën 3/b të Kreu-¹ të III të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*” i ndryshuar, KVK e miratuar me DST, Udhëzimin e APP, i cili përcakton se para lidhjes së kontratës OE duhet të paraqesë dokumentacionin administrativo ligjor në formë të shkruar të paraqitur në tender, origjinal ose fotokopje e noterizuar, i cili verifikohet nga KVO dhe bëhet pjesë e dosjes së tenderit, si dhe përcaktimet e parashikuara në nenin 1, “*Objekti dhe qëllimi*”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar.

6. Për BOE “**R..**” sh.p.k. dhe “**I..... c.....**” sh.p.k. në vlerën **940,520 lekë**, e cila përfaqëson TVSH-në e përfituar në tenderin me objekt “*Rikonstruksion i pjesshëm ... në godinën e Ministrisë së Mbrojtjes*”, në kundërshtim me germën A/7 paragrafi i fundit i UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “*Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit*”, e cila përcakton se në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat.

7. Për BOE “**B....**” sh.p.k. dhe “**A...**” sh.p.k. në vlerën **235,200 lekë**, e cila përfaqëson TVSH-në e përfituar në tenderin me objekt “*Rikonstruksioni i infrastrukturës së rrjetit për MM*”, në kundërshtim me germën A/7 paragrafi i fundit i UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “*Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit*”, e cila përcakton se në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat.

8. Për operatorin “**S... –A.**” sh.p.k., në vlerën **539 840 lekë**, cila përfaqëson sipërfaqen shtesë të shfrytëzuar por të pa paguar nga OE, në kundërshtim me sa përcakton kontrata e qirasë, lidhur midis KDS dhe OE “**S... a..**” sh.p.k.

9. Për operatorin “**K..**” sh.p.k., në vlerën **387,264 lekë**, cila përfaqëson sipërfaqen shtesë të shfrytëzuar por të pa paguar nga OE, në kundërshtim me sa përcaktojnë dy kontratat e qirasë, lidhur midis KFT Reparti ushtarak Zall Herr dhe OE “**K..**” sh.p.k.

10. Për operatorin “H..... A.....” sh.p.k. në vlerën **352,640 lekë**, cila përfaqëson sipërfaqen shtesë të shfrytëzuar por të pa paguar nga OE, në kundërshtim me sa është përcaktuar në kontratën e qirasë, lidhur midis KFA në Repartin Ushtarak nr. 3001, Rinas Tiranë dhe OE “H..... A.....” sh.p.k.

11. Për operatorin “G.... T.....” sh.p.k. në vlerën **352,640 lekë**, cila përfaqëson sipërfaqen shtesë të shfrytëzuar por të pa paguar nga OE, në kundërshtim me sa është përcaktuar në kontratën e qirasë, lidhur midis KFA në Repartin Ushtarak nr. 3001 Rinas Tiranë dhe OE “G.... T.....” sh.p.k.

Menjëherë

C. MBI ZBATIMI ME EFICENSË, EFIKASITET DHE EKONOMICITET I FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjatë auditimit të procedurave të prokurimit, u konstatua se procedura e tenderit me objekt:

- “Blerje furnizim, instalim, vënia në punë e SIVHD ...” zhvilluar në vitin 2014, me vlerë të realizuar të kontratës rreth 85,000 mijë lekë, fituar me vlerë të plotë, është vendosur e “klasifikuar” në nivelin e sigurisë “I kufizuar”, e cila nuk i nënshtrohet ligjit “Për prokurimin publik” nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.

Nga verifikimi në tërësi i dokumentacionit të dosjes, përfshirë dhe pasqyrën e inventarit shoqërues të dosjes, u konstatua se konsiderimi i kësaj procedure tenderi “I klasifikuar” në nivelin e sigurisë “I kufizuar”, nuk është i mbështetur në ndonjë dokument.

I njëjti tender në vitin 2011 është zhvilluar me procedurë “I hapur”, në zbatim të ligjit “Për prokurimin publik” nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.

Gjatë llogaritjes së fondit limit, AK është shprehur se për çmimet e artikujve objekt tenderi, i është referuar katalogëve përkatës të “G... Itali, “L.... & M....” sipas çmimeve të librave të kontabilitetit të vendosura nga hyrjet e bëra nga kjo kompani, e cila është zbatuese e projektit të SIVHD, Dell” etj, por ky moment nuk është i vërtetuar me dokumentacion.

Në çdo rast AK ka pranuar/zbatuar çmimet e propozuara nga OE “I.... T...” sh.p.k, e cila është dhe fituese e tenderit.

- “Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrjetit të klasifikuar ...” , i zhvilluar në vitin 2014 me procedurë “I hapur”, është në zbatim të ligjit “Për prokurimin publik” nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, me vlerë 29,200 mijë lekë dhe efekt gare rreth 10 për qind.

- “Sistemi i administrimit financiar Alfa Web”, me fond limit 2,038 mijë lekë, fituar me vlerë të plotë, është trajtuar si prokurim për “Mbajtjen kombëtare” në kundërshtim me nenin 5 të ligjit “Për prokurimin publik” nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.

- Nga të dhënat konstatohet se AK, për blerje të së njëjtës natyrë ka përdorur standard të dyfishtë, i cili ka ndikuar direkt në shmangien e procedurës së tenderit nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, me efekt të drejtpërdrejtë në uljen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik.

Për këtë është rekomanduar:

Autoriteti kontraktor, gjatë ushtrimit të aktivitetit, duke respektuar kushtet e sigurisë, të orientoj/realizojë kryerjen e shpenzimeve në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, me qëllim sigurimin e transparencës, konkurrencës etj, në mirë përdorimin e

fondeve publike.

Duke pasur në konsideratë që tenderi me objekt “Blerje furnizim, instalim, vënia në punë e SIVHD ...” është i përvitshëm, autoriteti kontraktor të orientojë/organizojë marrjen e masave të nevojshme për realizimin e tij, direkt nga prodhuesi (njëlloj si për “Blerjet për qëllime ushtarake”), e cila ndikon në uljen e shpenzimeve publike. Autoriteti kontraktor gjatë llogaritjes të fondit limit, të evidentojë burimin e çmimeve për mallra/punët objekt prokurimi të ofruara dhe në çdo rast t’i dokumentojë ato, në zbatim pikës 2 të Kreu-¹ të III të VKM 1, datë 10.1.2007.

Në vijimësi

2. Në përfundim të auditimit të tenderit me objekt “Rikonstruksion i pjesshëm ... në godinën e Ministrisë së Mbrojtjes”, me vlerë 50,172 mijë lekë, u konstatua se:

2.1. Njësia e prokurimit ka vendosur kriteret të gabuara që kanë ndikuar në zhvillimin e procedurës së tenderit dhe kualifikimin e OE si: zgjedhja e procedurës “me negociim” është në kundërshtim me nenin 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, vendosja numrit të punonjësve, Licencat e kërkuara etj.

Në thelb, me praktikën e ndjekur njësia e prokurimit, ka përgatitur kushte për të kualifikuar OE, pa besueshmërinë e duhur për kryerjen e punimeve, në kundërshtim me nenin 2 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

2.2. KVO dhe njësia e prokurimit kanë gabuar në përzgjedhjen e OE që janë ftuar për të marrë pjesë në tender. OE të ftuar, qysh në momentin e përzgjedhjes dukshëm, nuk plotësojnë kriteret që ka kërkuar AK, çka komprometon garën prej nisjes, duke e paragjykuar atë. OE fitues është shoqëri “pastrimi” dhe pas verifikimit të kualifikimit të tyre, rezultoi se të gjithë punëtorët e OE fitues, janë “Fshesarë”.

2.3. KVO ka kualifikuar dhe shpallur fituesin në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST të miratuara.

Parregullsitë e evidentuara në pikën 1 janë konstatuar edhe në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i infrastrukturës së rrjeteve për MM”, me fond limit 38,632,278 lekë.

2.4. Instituti i projekteve të MM nuk ka shoqëruar projekt preventivin me një relacion shpjegues në të cilin të jetë e përfshirë domosdoshmëria e kryerjes së investimit etj, në kundërshtim me pikën 1/ të kreu-t V të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar etj.

2.5. Kryesisht punimet e ndërtimit janë parashikuar “prishje” dhe “ndërtim” i njëjti zë në të njëjtin vend, si “prishje tavani me knauf”, “ndërtim tavani me knauf”, “Heqje muri me mermer”, “ndërtim fasada me mermer”, “sistemi i kondicionimit” etj.

Element që evidentohet është fakti që në godinën ku aktualisht është vendosur MM (objekti ku janë kryer punimet), janë kryer investime në shumën 140,904 mijë lekë.

si më poshtë:

- Rikonstruksion kati II, III, IV me vlerë 62,489 mijë lekë, viti 2005.
- Rikonstruksion “Holli” (kati i I) me vlerë 25,867 mijë lekë, viti 2007.
- Sistemi i ngrohje ftohje me vlerë 52,548 mijë lekë, viti 2008.

2.6. Njësia e prokurimit ka lejuar zhvillimin e procedurave të tenderit, në kushtet kur projekt preventivi i objektit nuk ka kaluar për miratim në organet përkatëse për t’u pajisur me leje

zhvillimi/ndërtimi, në kundërshtim me nenin 15, 16 të VKM nr. 502, datë 13.7.2009 i ndryshuar. Njësia e prokurimit është përgjegjëse në zbatim të pikës 1/c dhe 2/a, Kreu V i VKM nr. 1, datë 10.1.2007 i ndryshuar, në të cilën është përcaktuar se ... *Njësia e prokurimit është përgjegjëse për hartimin e dokumenteve të tenderit, në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi.* Pjesë e DT ndër të tjera si projekt preventivi, grafiku i punimeve është dhe leja e ndërtimit/zhvillimit.

Për këtë është rekomanduar:

Njësia e prokurimit, për të gjitha punimet e ndërtimit të kërkojë/ hartojë dokumentacionin e tenderëve, në përputhje me objektin e prokurimit. Plotësia e dokumentacionit të mos kufizohet vetëm me kërkesat e drejtpërdrejta që kërkon ligji “*Për prokurimin publik*”, por me tërësinë e kërkesave tyre, përfshirë dhe kritere specifike të imponuara nga dispozita të tjera ligjore, nëpërmjet të cilave mundësohet realizimi i investimit.

Në vijimësi

3. Në inventarin e Forcës ajrore të M M, ka një numër të caktuar helikopterësh të blerë pas vitit 2004. Ky numër është reduktuar me rreth 40 për qind kryesisht për shkak të kostos së lartë të mirëmbajtjes së tyre. Aktualisht në punë është rreth 30 për qind e inventarit mjeteve, pas reduktimit të tyre. Pjesa tjetër e mjeteve, nuk është në gatishmëri edhe kjo, kryesisht për shkak të kostos së mirëmbajtjes së tyre.

Shpenzimet për këto mjete bëhen më pak efektive duke pasur në konsideratë se krahas shpenzimeve direkt për blerjen, janë shpenzuar fonde të konsiderueshme për kualifikimin e personelit dhe reduktimi i tyre, ka bërë që efektiviteti i shpenzimeve të jetë edhe më i ulët. Për çdo tipi helikopteri, kërkohet kualifikim i veçantë i personelit. Shpenzimet bëhen edhe më pak efektive edhe për shkak se janë të linjave (*prodhimeve*) të ndryshme (*tre linja*) dhe të tipave (*gjashtë tipe*) të ndryshme.

Kjo shumëllojshmëri, rrit më tej kostot dhe nuk lejon/krijon mundësinë që pjesët e këmbimit të rregullta të një mjeti të reduktuar, ose jo në gatishmëri, të përdoren nga një mjet tjetër, duke çuar në rritjen e numrit të mjeteve që nuk janë në punë. Mirëmbajtja dhe përgatitja e personelit bëhet në kompani private.

Nga njohja me kontratën, marrëveshjen për blerjen e disa helikopterëve bashkëkohorë të realizuar gjatë vitit 2012 - 2014, u konstatua se blerja e tyre, nuk është shoqëruar me konsulencë/oponencë, nga kompani të të njëjtit nivel, ekspertë të fushës, me qëllim vendosjen e parametrave, treguesve specifikë, aparaturave të ndryshme, bashkëkohore. Për specialistët shqiptarë, firmosja e kontratave për blerje të tilla, realisht është jashtë mundësive të tyre. Në tërësi sa më sipër, rezulton se kryerja e këtyre shpenzimeve është pa efektivitet.

Për të rritur efektivitetin e shpenzimeve është rekomanduar:

Blerja e mjeteve ajrore të mbështetet në nevojat që ka vendi, por mbi të gjitha, në mundësitë financiare për mirëmbajtjen periodike deri në një periudhë kohore të pranuar teknikisht për këto mjete. Blerja e mjeteve të orientohet në kufizimin e mundshëm të linjave dhe tipeve të prodhimit. Për shkak të kostos së lartë dhe teknologjisë së avancuar, për të garantuar cilësinë e mjeteve objekt blerje, të shikohet mundësia që vendosja e specifikimeve teknike, lidhja dhe zbatimi i kontratës, të asistohet/konsultohet me kompani të të njëjtit nivel.

Mirëmbajtja e mjeteve dhe përgatitja e personelit, të orientohet drejt marrëveshjeve shtetërore me vendet e NATO-s, me qëllim, jo vetëm uljen e çmimit, por edhe shmangien e abuzimeve të mundshme.

4. Nga Komanda e Forcës Ajrore, me urdhër shpenzimi nr. 284, datë 11.09.2013, referuar kontratës së lidhur me kompaninë dhe raportit të pagesave, është bërë ngurtësimi i fondeve për hapjen e kredisë së tretë dokumentare, si pagesë balancuese e helikopterit “Cougar AS532AL” në konfigurim TTH, *pasi më parë është marrë miratimi nga Ministri i Financave* dhe është lidhur kontrata e L/C me “C.... Bank”, ku fondet e nevojshme janë mbuluar nga depozita në valutë e Qeverisë në Bankën e Shqipërisë

Me shkresë të Sekretarit të Përgjithshëm nr. 8080, datë 18.09.2013, i është kërkuar drejtuesit të “C.... Bank” pezullimi i menjëhershëm i procedurave për çeljen e Letër Kreditit, deri në një njoftim të dytë.

Vetëm pas një kërkesë në rrugë elektronike të Kompanisë më datë 13.03.2014 janë rivënë në lëvizje për kryerjen e veprimit dhe me shkresën nr. 2758, datë 01.04.2014 të Sekretarit të Përgjithshëm, i është kërkuar Komandës së Forcës Ajrore kryerja e pagesës, ndërsa nga banka veprimi është kryer më datë 15.04.2014, *pra pas 7 muajsh nga kryerja e veprimit me L/C, duke i mbajtur fondet të bllokuara në një bankë të nivelit të dytë, ndërkohë që ishin depozitë e Qeverisë.*

Kjo shtyrje e pa justifikuar e kësaj pagese, referuar nenit 12 “Dërgimi”, pika 12.4.1, të kontratën nr. 6853/10, datë 17.12.2009, *“Për furnizimin me 5 helikopterë të mesëm shumërolësh” të ndryshuar, përcaktohet se: “Çdo vonesë në datat e pagesës nga Blerësi siç përcaktohet në nenin 11, do të përfshijë të njëjtën kohë shtyrjeje në tabelën e lëvrimit...”, ka sjellë riskun e shtyrjes së afatit të ardhjes së helikopterëve, e cila do të shoqërohet me efekte financiare në të ardhmen, dhe përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 52, 54 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenin 5 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.*

Për këtë është rekomanduar:

Të eliminohen praktika të tilla (Letër Kredi) në realizimin e shpenzimeve buxhetore, sidomos në fund të vitit. Në raste të veçanta (të përcaktuara qartësisht me akte normative), të ketë formate ku specifikohen qartë kushtet e përdorimit të LC, në veçanti për masën e komisioneve dhe mënyrën e pagesës së tyre, pasi të sigurohet dakordësia me Ministrinë e Financave. Rekomandojmë me forcë që në këtë proces të përcaktimit të marrëveshjeve dhe kushteve të tyre, të sigurohet që strukturat drejtuese të bashkëpunojnë me Ministrinë e Financave dhe domosdoshmërisht me Bankën e Shqipërisë.

Të nxirret përgjegjësia institucionale për raportimin e buxhetit në kundërshtim me rregullat dhe parimet bazë buxhetore, lidhur me deklarin e investimeve/shpenzimeve të pa kryera si të realizuara.

Menjëherë

Në tërësi veprimet e mësipërme kanë çuar në përdorimin pa *eficencë, efikasitet, ekonomikitet të fondeve publike, të shoqëruar me efekte financiare negative.*

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, pika b, në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në referim të nenit 57, 58, 59 të ligjit nr. 152/2013, datë

13.05.2013 “*Statusi i nëpunësit civil*”, kreu II i VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, nenit 17, 18 dhe 47 të Ligjit nr. 9210 datë 23.03.2004 “*Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar, nenit 7, 8 etj, të ligjit nr. 173/2014, datë 18.12.2014 “*Për disiplinën në forcat e armatosura në Republikën e Shqipërisë*”, i rekomandojmë Ministrit të mbrojtjes referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve, si dhe përgjegjësi individuale të evidentuara dhe pasqyruar në procesverbalet dhe aktverifikimet përkatës, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit të vlerësojë shkeljet e konstatuara, dhe të vendosë marrjen e masave administrative dhe disiplinore, në raport me shkeljet e konstatuara, për personat si më poshtë:

2. Kolonel **M. M**, me detyrë Z/V Komandant i KFA,
3. N/Kolonele **O. N**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës së KFA,
4. Kolonel **S. Ç** dhe
5. N/Kolonel **A.L**, me detyrë ish Komandantë të Repartit Ushtarak nr. 3006,
6. Kolonel **K. H**, me detyrë Komandantë të Repartit Ushtarak nr. 3006,
7. Zj. **L. A**, me detyrë ish Shefe e Financës e Repartit 3006, për shkak se gjatë zbatimit të kontratës së tenderit me objekt “*Furnizimi me 5 helikopterë të mesëm shumërolësh*” e ndryshuar, nëpërmjet veprimeve të kryera/moskryerja prej tyre, kompanisë “E.....” i janë likuiduar katër kite me vlerë 3,458,142 euro, ndërkohë që vlera e katër kiteve sipas dokumentacionit të bërë hyrje është në 2,764,348 euro, ose 639,794 euro më pak.
8. **Z. Ë. Ç**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme së Standarteve të NATO-s dhe Modernizimit,
9. Kapiten i Rangut të II **A.Sh**, me detyrë Shef i Sektorit të Hartimit të Projekteve, në cilësinë e kryetarit të grupit të punës për hartimin e projektit teknik.
10. N/kolonel **M. K**, me detyrë Shef Shtabi në Policinë Ushtarake dhe në cilësinë e anëtarit të grupit të punës.
11. **Z. B. D**, Kapiten, me detyrë shef logjistike në Policinë Ushtarake dhe në cilësinë e anëtarit të grupit të punës.
12. **Z. B. B**, Kapiten, me detyrë Komandat i Kompanisë operacionale në Policinë Ushtarake,
13. **Z. N. G** dhe
14. **Z. E.D** në cilësinë e anëtarit të grupit të punës, pasi në tenderin me objekt “*Blerje mjete të blinduara për policinë ushtarake me kompaninë “I.... s.p.a”*”, kanë rritur në mënyrë të pajustificuar, fondin limit nga 1,200,000 Euro të parashikuar në projektin fillestar të propozuar nga Komanda e Policisë Ushtarake, në 1,420,000 Euro, ose 220,000 euro më shumë.
15. Major **A. Z**, në cilësinë e kryetarit,
16. Kapiten **K. T**,
17. Kapiten **H. B**,
18. **F. Ç**, përgjegjës materiali, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të pritjes së mallit të Repartit Ushtarak nr. 2002
19. **G. J**,
20. **E. F**,
21. **R. R**, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit pasi në tenderin me objekt “*Blerje materiale për flotën luftarake*”, Komisioni i pritjes së mallit ka pranuar dhe marrë në dorëzim pjesët e ndërrimit objekt tenderi, të pa shoqëruar me certifikatë origjinë, cilësie dhe fletë

garancie. Artikujt e furnizuar nuk janë në përputhje me të dhënat e kërkuara në katalogët dhe skedën teknike, që OE fitues ka paraqitur në ofertë, në kundërshtim me:

- paragrafin e tretë nga fundi i KVK të miratuar me DST, në të cilin është përcaktuar se ... *OE që kualifikohen në këtë procedurë duhet të paraqesin një deklaratë ku të deklarojnë se në momentin e dorëzimit të mallit do ta shoqërojnë atë me certifikatën e cilësisë, certifikatën e origjinës së mallit dhe fletën e garancisë për mallrat e kërkuara.*

- pikën 2.3.3. germa b dhe c të KVK, në të cilat është përcaktuar se ... *Produkti me specifikimet të dhëna nga AK në DST duhet të jetë i përfshirë në përmbajtje të katalogëve ose prospekteve teknike të mësipërm. Për çdo ofertues është e domosdoshme të plotësohet skeda teknike e materialeve. Mos paraqitja e katalogëve ose prospekteve **nën autoritetin e prodhuesit** si dhe mosparaqitja e të dhënave të kërkuara në katalogët dhe në skedën teknike është kusht kualifikues*

OE “A.... Co” sh.p.k. nuk i ka shoqëruar artikujt e furnizuar me dokumentacionin e kërkuar. Njësia e prokurimit është bashkë përgjegjëse për parregullsitë e konstatuara pasi, në dokumentacionin e dërguar Repartit Ushtarak nr. 2002 në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, nuk i ka dërguar KVK me qëllim që “Komisioni i pritjes së mallit ...” të bënte krahasimin me sa është përcaktuar në KVK.

Si rezultat i parregullsive buxhetit të MM i është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **2,079,096 lekë**, e cila përfaqëson diferencën midis ofertës ekonomike të OE “A.... Co” sh.p.k. të shpallur fitues dhe OE “B....” sh.p.k. të skualifikuar.

Veç sa më sipër, **G. J** dhe **R. R**, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit në është përgjegjës pasi në tenderin me objekt:

a. *“Blerje materiale për mirëmbajtjen e kazermave”* me fond limit 23,583,536 lekë.

b. *“Blerje materiale për mirëmbajtje objekte ndërtimore”* me fond limit 3,189,265 lekë, fituar nga subjekti “A.. & R..” sh.p.k. me 3,169,290 lekë. Diferenca ndaj fondit limit 19,975 lekë, ose 0,6 për qind.

c. *“Blerje materiale për flotën luftarake”* me fond limit 30,000,000 lekë, fituar nga subjekti “A.... Co” sh.p.k. me 29,640,000 lekë. Diferenca ndaj fondit limit 360,000 lekë, ose 1 për qind. Në sistemin elektronik të APP rezultojnë 4 OE, nga të cilët kanë paraqitur oferta 2 OE, njeri prej të cilëve janë skualifikuar.

Ka mbetur një ofertë e vlefshme, e cila është shpallur dhe fituese.

d. *“Blerje pjesë këmbimi dhe materiale për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit”* tre lote me fond limit 22,692,465 lekë, nga i cili Loti i tretë me fond limit 3,389,100 lekë, fituar nga OE “Al....” sh.p.k. me 3,361,750 lekë. Diferenca ndaj fondit limit 27,350 lekë, ose 0,8 për qind.

e. *“Blerje materiale riparimi për flotën KFD”* me fond limit 16,357,851 lekë, fituar nga BOE “H....” sh.p.k. dhe “A.... Co” sh.p.k. me vlefte 16,217,943 lekë. Diferenca ndaj fondit limit 139,908 lekë, ose 0,9 për qind. Është paraqitur vetëm një OE.

f. *“Blerje materiale teknike për anijet e klasit Iliria”* me fond limit 9.659,600 lekë fituar nga OE “A.... Co” sh.p.k. me vlefte 9,481,500 lekë. Diferenca ndaj fondit limit 178,100 lekë, ose 1,8 për qind.

Parregullsi e konstatuar:

Njësia e prokurimit e përbërë ka hequr nga KVK kriterin që OE pjesëmarrës në tender të paraqesin certifikatën e cilësisë dhe origjinës ... dhe fletën e garancisë për artikujt objekt prokurimi, në kundërshtim me:

1. pikën 3/b,i të Kreu^t të III të VKM nr. 1, datë 10.1.2007, e cila përcakton se ... *Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

- *dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogët*

teknike ...

- dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2. Shtojcën 7 “Formular për vërtetimin e kualifikimit të pjesëmarrjes” pjesë e DST të miratuar.

Njësia e prokurimit padrejtësisht, e ka trajtuar këtë kriter si specifikim teknik, duke ja lënë detyrë për ta kërkuar AK, në momentin e dorëzimit të mallit.

Me këtë veprim, njësia e prokurimit ka ndikuar në procedurën e zhvillimit të tenderit (kualifikimin/skualifikimin e OE).

Përgjithësisht në KVK, për tenderët e zhvilluar, njësia e prokurimit ka kërkuar që ofertuesi të paraqesë certifikatë ISO 9001:2008 origjinale, ose kopje e notuar, por pa ekzistuar ndonjë lidhje midis ofertuesit dhe prodhuesit.

Certifikata origjinale ISO ... jepet vetëm njëherë (një kopje) me afat vlefshmërie disa vjet.

Në këtë situatë OE ofertues, natyrshëm kanë shkarkuar nga interneti certifikatat e kërkuar, të cilat dhe i kanë notuar, por që në thelb, ashtu si i ka kërkuar njësia e prokurimit, pa lidhje midis ofertuesit dhe prodhuesit, nuk ka vlerë për AK, është kriter kualifikues i vendosur pa kuptim.

Në thelb vendosja e kriterëve të tilla, shoqëruar me një numër katalogësh të paraqitura nën autoritetin e prodhuesit etj, vetëm sa “*dekurajojnë*”, kufizojnë OE të marrin pjesë në tender (në tenderët e përshkruar në katër prej tyre është paraqitur një ofertues, kurse në dy të tjerë janë paraqitur dy OE, njeri prej të cilëve është skualifikuar).

Njësia e prokurimit është përgjegjëse gjithashtu, pasi në dokumentacionin e dërguar AK, nuk janë përfshirë dhe KVK, me qëllim që “*Komisioni i pritjes së mallit ...*” të AK, të kishte mundësinë gjatë marrjes në dorëzim të mallrave në zbatim të KVK:

- Të bënte krahasimin nëse artikujt e furnizuar janë të njëjtë me ata të parashikuara në ofertë dhe

- Nëse mallrat e furnizuara janë të shoqëruar me *certifikatën e cilësisë, origjinës... dhe fletën e garancisë* për artikujt objekt prokurimi.

Nga verifikimi i procedurës së ekzekutimit të kontratës për të katër tenderët, në dokumentacionin e paraqitur nga OE, u konstatuan të njëjtat parregullsi në plotësimin e KVK, të cilat janë pasoje e përcaktimit jo të saktë të tyre nga njësia e prokurimit.

OE fitues, në momentin e dorëzimit të mallit nuk kanë paraqitur *certifikatën e origjinës së mallit dhe fletën e garancisë...*, si dhe artikujt të furnizuar prej tyre, nuk janë të kompanive prodhuese të përcaktuara në ofertën e paraqitur nga OE fitues, në kundërshtim me KVK të përcaktuara.

Fakti se:

- pjesëmarrja e OE në tenderë është shumë e ulët (përgjithësisht një),

- tenderët fitohen me vleftë të plotë dhe

- fituesi është përgjithësisht i njëjti (A... *Co fitues në tre tenderë gjatë vitit 2014, fitues edhe në vitin 2013 etj.*), komprometon në tërësi procedurat e tenderëve të zhvilluar.

Gjithashtu, G. J, në cilësinë e anëtarit të KVO në tenderin me objekt:

“*Rikonstrukcion i pjesshëm ... në godinën e Ministrisë së Mbrojtjes*”,

“*Rikonstrukcioni i infrastrukturës së rrjeteve për MM*”, me fond limit 38,632 mijë lekë pasi:

- ka gabuar në përzgjedhjen e OE që janë ftuar për të marrë pjesë në tender. OE të ftuar, qysh në momentin e përzgjedhjes dukshëm, nuk plotësojnë kriteret që ka kërkuar AK, çka komprometon garën prej nisjes, duke e paragjykuar atë OE fitues është shoqëri “*pastrimi*” dhe pas verifikimit të kualifikimit të tyre, rezulton se të gjithë punëtorët e OE fitues, janë “*Fshesarë*”.

-ka kualifikuar dhe shpallur fituesin në kundërshtim të ndjeshëm me kërkesat e përcaktuara në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST të miratuara.

22. M. R, në cilësinë e kryetares të KVO, për shkak se në tenderin me objekt:

22.1. “*blerje artikuj ushqimorë*” loti V “*blerje fruta perime*”, KVO ka vepruar në kundërshtim me:

- pikën 3/b të Kreu-^I të III të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*” i ndryshuar,

- KVK e miratuar me DST,

- Udhëzimin e APP, i cili përcakton se para lidhjes së kontratës OE duhet të paraqesë dokumentacionin administrativo ligjor ne forme te shkruar të paraqitur ne tender (*origjinal ose fotokopje e noterizuar*), i cili verifikohet (nga KVO-ja) dhe behet pjese e dosjes së tenderit,

- si dhe përcaktimet e parashikuara në nenin 1"Objekti dhe qëllimi", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar.

Si rezultat i parregullsive buxhetit të M M i është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 1,113,918 lekë, e cila përfaqëson diferencën midis ofertës të OE “S.... Co” sh.p.k. të skualifikuar padrejtësisht dhe “Sh....2002” sh.p.k. të shpallur fitues

22.2. “*Blerje materiale riparimi për flotën*” në procesin e vlerësimit të tij, ka kualifikuar BOE “H....” sh.p.k. dhe “A.... Co” sh.p.k. në kundërshtim me pikën 2 të Kreu-^I të VII të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*” i ndryshuar dhe pikën 2.1.3. të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit (KVK) . Në sistemin elektronik të APP, nuk gjendet vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të faturuara të energjisë elektrike nga OE “H....” sh.p.k. në kundërshtim me pikën 2.1.3 të KVK të miratuara në DST nga AK dhe pikën 2 të VKM nr. 379, datë 11.6.

22.3. “*Blerje materiale për mirëmbajtje objekte ndërtimorë*”, ka konsideruar të rregullt vërtetimin e energjisë elektrike të paraqitur nga OE “A... & R...” sh.p.k. në kundërshtim me pikën 2.2.4 të KVK dhe pikën 2 të VKM nr. 379, datë 11.6.2014 .

Ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “A.. & R...” sh.p.k, në **mungesë** të “*dëshmisë së origjinalitetit*” dhe fotografive, ose katalogëve për artikujt “*markë e regjistruar*”, në kundërshtim me pikën 2.3.1. të KVK.

23. M. O, në cilësinë e anëtarit të KVO/njesisë së prokurimit për shkak se në tenderin me objekt:

23.1. “*blerje artikuj ushqimorë*” loti V “*blerje fruta perime*”, KVO ka vepruar në kundërshtim me:

- pikën 3/b të Kreu-^I të III të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “*Për rregullat e prokurimit publik*” i ndryshuar,

- KVK e miratuar me DST,

- Udhëzimin e APP, i cili përcakton se para lidhjes së kontratës OE duhet të paraqesë dokumentacionin administrativo ligjor ne forme te shkruar të paraqitur ne tender (origjinal ose fotokopje e noterizuar), i cili verifikohet (nga KVO-ja) dhe behet pjese e dosjes së tenderit,

- si dhe përcaktimet e parashikuara në nenin 1"Objekti dhe qëllimi", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar.

Si rezultat i parregullsive buxhetit të M M i është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 1,113,918 lekë, e cila përfaqëson diferencën midis ofertës të OE “S....Co” sh.p.k. të skualifikuar padrejtësisht dhe “Sh....2002” sh.p.k. të shpallur fitues.

23.2. “*Blerje materiale riparimi për flotën*”

Në procesin e vlerësimit të tij, ka kualifikuar BOE "H..." sh.p.k. dhe "A.... Co" sh.p.k. në kundërshtim me pikën 2 të Kreu-¹ të VII të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar dhe pikën 2.1.3. të KVK .

Në sistemin elektronik të APP, nuk gjendet vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të faturuara të energjisë elektrike nga OE "H..." sh.p.k. në kundërshtim me pikën 2.1.3 të KVK të miratuara në DST nga AK dhe pikën 2 të VKM nr. 379, datë 11.6.

23.3. *"Blerje materiale për mirëmbajtje objekte ndërtimore"*,

- ka konsideruar të rregullt vërtetimin e energjisë elektrike të paraqitur nga OE "A... & R..." sh.p.k. në kundërshtim me pikën 2.2.4 të KVK dhe pikën 2 të VKM nr. 379, datë 11.6.2014

- ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE "A... & R..." sh.p.k, në **mungesë** të "dëshmisë së origjinalitetit" dhe fotografive, ose katalogëve për artikujt "markë e regjistruar", në kundërshtim me pikën 2.3.1. të KVK.

23.4. *"Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrjetit të klasifikuar dhe paklasifikuar ..."* ka konsideruar të rregullt padrejtësisht dokumentacionin e paraqitur nga OE "J.... k... sistem" sh.p.k, në kundërshtim me pikën 2.2.2. KVK.

Zj. M. O, mban përgjegjësi edhe për mos skualifikimin e OE "A..." sh.p.k. gjatë dorëzimit të pjesëve, në zbatim të tenderit me objekt "Blerje pjesë për mjetet e transportit".

E veçantë që u konstatua gjatë marrjes në dorëzim të mallrave të furnizuara nga OE "A...." sh.p.k. është se Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) me shkresë nr. 2407, datë 16.12.2014 të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Kolonel N.Sh, i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Standardeve të NATO-s "Mendim" për subjektin "A...." sh.p.k, në të cilin është shprehur se ... *Mbi bazën e dokumenteve standarde të tenderit, dërguar nga ana juaj për këtë procedurë (loti i III "blerje pjesë ndërrimi ...") në formularin e ofertës ka përcaktuar numrin e katalogut/kodit të artikullit. Gjatë marrjes në dorëzim të mallit nga komisioni përkatës, ka rezultuar se kodet e përcaktuara nuk ishin të pasqyruar në asnjë nga artikujt e kërkuar. Po kështu, gjatë kërimit me këto kode, nuk shfaqej artikulli i kërkuar, por artikull tjetër.*

Nga verifikimi që specialistët tanë i kanë bërë artikujve të ardhur, rezulton se ato përputhen me përshkrimin e atyre të kërkuar (specifikimet teknike). Artikujt në fjalë janë marrë na ruajtje nga ana jonë, deri në sqarimin e këtij problemi.

Zj. M. O, në cilësinë e Drejtores së Drejtorisë së Përgjithshme të Standardeve të NATO-s me shkresë nr. 5022, datë 22.12.2014 është shprehur se ... *në specifikimet teknike sipas shtojcës 8, të DST të procedurës në fjalë, përcaktohet si më poshtë: pjesët e këmbimit objekt i prokurimit të jenë të cilësisë së mirë dhe të përshtatshme për markën, vitin e prodhimit, dhe tipin e automjetit.*

Përgjigja e dhënë është në kundërshtim me pikën 2.2.2. të KVK, të DST të miratuar, në të cilën është përcaktuar se ... *kjo kërkesë është vendosur që të garantojë AK, se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim i së njëjtës kompani (garantohet cilësia) dhe paragrafin e tretë nga fundi i KVK, në të cilin është përcaktuar se ... me qëllim ruajtjen e këtij standardi është kërkuar që ofertuesit të marrin përsipër ... që mallrat që do të furnizojnë do të jenë prodhime të kompanive të përcaktuara në ofertë e ngarkon me përgjegjësi zj. M. O.*

23.5 *"Rikonstruksion i pjesshëm ... në godinën e Ministrisë së Mbrojtjes"*,

23.6. *"Rikonstruksioni i infrastrukturës së rrjeteve për MM"*, me fond limit 38,632,278 lekë pasi:

- ka gabuar në përzgjedhjen e OE që janë ftuar për të marrë pjesë në tender. OE të ftuar, qysh në momentin e përzgjedhjes dukshëm, nuk plotësojnë kriteret që ka kërkuar AK, çka komprometon garën prej nisjes, duke e paragjykuar atë OE fitues është shoqëri "pastrimi" dhe pas verifikimit të kualifikimit të tyre, rezulton se të gjithë punëtorët e OE fitues, janë "Fshesarë".

- ka kualifikuar dhe shpallur fituesin në kundërshtim të ndjeshëm me kërkesat e përcaktuara në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST të miratuara.

24. E. T, në cilësinë e anëtarit të KVO/njesisë së prokurimit, për shkak se në tenderin me objekt:

24.1. “*blerje artikuj ushqimorë*” loti V “*blerje fruta perime*”, KVO ka vepruar në kundërshtim me:

- pikën 3/b të Kreu-^I të III të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 i ndryshuar,
- KVK e miratuar me DST,
- Udhëzimin e APP, i cili përcakton se para lidhjes së kontratës OE duhet të paraqesë dokumentacionin administrativo ligjor në formë të shkruar të paraqitur në tender (*original ose fotokopje e noterizuar*), i cili verifikohet (nga KVO-ja) dhe behet pjesë e dosjes së tenderit,
- si dhe përcaktimet e parashikuara në nenin 1 “*Objekti dhe qëllimi*”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.

Si rezultat i parregullsive buxhetit të M M i është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 1,113,918 lekë, e cila përfaqëson diferencën midis ofertës të OE “S... Co” sh.p.k. të skualifikuar padrejtësisht dhe “Sh....2002” sh.p.k. të shpallur fitues

24.2. “*Blerje materiale riparimi për flotën*”

Në procesin e vlerësimit të tij, ka kualifikuar BOE “H...” sh.p.k. dhe “A.... Co” sh.p.k. në kundërshtim me pikën 2 të Kreu-^I të VII të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar dhe pikën 2.1.3. të KVK .

Në sistemin elektronik të APP, nuk gjendet vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të faturuara të energjisë elektrike nga OE “H....” sh.p.k. në kundërshtim me pikën 2.1.3 të KVK të miratuara në DST nga AK dhe pikën 2 të VKM nr. 379, datë 11.6.

24.3. “*Blerje materiale për mirëmbajtje objekte ndërtimore*”,

- ka konsideruar të rregullt vërtetimin e energjisë elektrike të paraqitur nga OE “AN & RA” sh.p.k. në kundërshtim me pikën 2.2.4 të KVK dhe pikën 2 të VKM nr. 379, datë 11.6.2014
- ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “A... & R...” sh.p.k. në **mungesë** të “dëshmisë së origjinalitetit” dhe fotografive, ose katalogëve për artikujt “markë e regjistruar”, në kundërshtim me pikën 2.3.1. të KVK.

24.4. “*Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrjetit të klasifikuar dhe paklasifikuar ...*” ka konsideruar të rregullt padrejtësisht dokumentacionin e paraqitur nga OE “J.... k.... sistem” sh.p.k. në kundërshtim me pikën 2.2.2. KVK.

24.5 “*Rikonstruktion i pjesshëm ... në godinën e Ministrisë së Mbrojtjes*”, në cilësinë e anëtarit të njesisë së prokurimit, ka vendosur kriteret të gabuara që kanë ndikuar në zhvillimin e procedurës së tenderit dhe kualifikimin e OE si:

- Zgjedhja e procedurës “me negocim” është në kundërshtim me nenin 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006,-
- Vendosja numrit të punonjësve,
- Licencat e kërkuara etj.
- Nuk ka kërkuar që paraprakisht projekti rikonstruktionit etj, fillimi i procedurës së tenderit të kryhet, pasi Autoriteti kontraktor të jetë i pajisur me leje zhvillimi/ndërtimi në kundërshtim me nenin 15, 16 të VKM nr. 502, datë 13.7.2009 i ndryshuar.
- Ka lejuar që se procedura e tenderit me objekt “*Blerje furnizim, instalim, vënia në punë e SIVHD ...*” zhvilluar në vitin 2014, me vlerë të realizuar të kontratës rreth 85,000 mijë lekë, fituar me vlerë të plotë, të jetë zhvilluar “*sekret*” në nivelin e sigurisë “*I kufizuar*”, në mungesë të një dokumenti dalë në zbatim të nenit 6 të ligjit “*Për prokurimin publik*” nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.

- ka gabuar në përzgjedhjen e OE që janë ftuar për të marrë pjesë në tender. OE të ftuar, qysh në momentin e përzgjedhjes dukshëm, nuk plotësojnë kriteret që ka kërkuar AK, çka komprometon garën prej nisjes, duke e paragjykuar atë OE fitues është shoqëri “pastrimi” dhe pas verifikimit të kualifikimit të tyre, rezulton se të gjithë punëtorët e OE fitues, janë “Fshesarë”. E njëjta parregullsi është vërejtur edhe në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i infrastrukturës së rrjeteve për MM”.

Në thelb, me praktikën e ndjekur njësia e prokurimit, ka përgatitur kushte për të kualifikuar OE, pa besueshmëri e duhur për kryerjen e punimeve, në kundërshtim me nenin 2 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

24.6 “Blerje furnizim, instalim, vënia në punë e SIVHD ...” ka lejuar/pranuar zhvillimin e procedurës së tenderit “Blerje furnizim, instalim, vënia në punë e SIVHD ...” si i “klasifikuar” në nivelin e sigurisë “I kufizuar”, në mungesë të miratimi të tillë, me pasojë shmangien e procedurës së prokurimit nga ligji 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.

25. J. K	“	“	“	“	“	“	a, e, f.
26. O. D	“	“	“	“	“	“	a, b.
27. S. D.	“	“	“	“	“	“	b.

pasi në tenderin me objekt:

- “Blerje materiale për mirëmbajtjen e kazermave” me fond limit 23,583,536 lekë.
 - “Blerje materiale për mirëmbajtje objekte ndërtimore” me fond limit 3,189,265 lekë, fituar nga subjekti “A.. & R...a” sh.p.k. me 3,169,290 lekë. Diferenca ndaj fondit limit 19,975 lekë, ose 0,6 për qind.
 - “Blerje materiale për flotën luftarake” me fond limit 30,000,000 lekë, fituar nga subjekti “A... Co” sh.p.k. me 29,640,000 lekë. Diferenca ndaj fondit limit 360,000 lekë, ose 1 për qind. Në sistemin elektronik të APP rezultojnë 4 OE, nga të cilët kanë paraqitur oferta 2 OE, njeri prej të cilëve janë skualifikuar.
- Ka mbetur një ofertë e vlefshme, e cila është shpallur dhe fituese.
- “Blerje pjesë këmbimi dhe materiale për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit” tre lote me fond limit 22,692,465 lekë, nga i cili Loti i tretë me fond limit 3,389,100 lekë, fituar nga OE “A....” sh.p.k. me 3,361,750 lekë. Diferenca ndaj fondit limit 27,350 lekë, ose 0,8 për qind.
 - “Blerje materiale riparimi për flotën KFD” me fond limit 16,357,851 lekë, fituar nga BOE “H....” sh.p.k. dhe “A.... Co” sh.p.k. me vleftë 16,217,943 lekë. Diferenca ndaj fondit limit 139,908 lekë, ose 0,9 për qind. Është paraqitur vetëm një OE.
 - “Blerje materiale teknike për anijet e klasit Iliria” me fond limit 9.659,600 lekë fituar nga OE “A.... Co” sh.p.k. me vleftë 9,481,500 lekë. Diferenca ndaj fondit limit 178,100 lekë, ose 1,8 për qind.

Parregullsi e konstatuar:

Njësia e prokurimit e përbërë ka hequr nga KVK kriterin që OE pjesëmarrës në tender të paraqesin certifikatën e cilësisë dhe origjinës ... dhe fletën e garancisë për artikujt objekt prokurimi, në kundërshtim me:

1. pikën 3/b,i të Kreu-¹ të III të VKM nr. 1, datë 10.1.2007, e cila përcakton se ... Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogët teknike ...

- dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

2. Shtojcën 7 “Formular për vërtetimin e kualifikimit të pjesëmarrjes” pjesë e DST të miratuar.

Njësia e prokurimit padrejtësisht, e ka trajtuar këtë kriter si specifikim teknik, duke ja lënë detyrë për ta kërkuar AK, në momentin e dorëzimit të mallit.

Me këtë veprim, njësia e prokurimit ka ndikuar në procedurën e zhvillimit të tenderit (kualifikimin/skualifikimin e OE).

Përgjithësisht në KVK, për tenderët e zhvilluar, njësia e prokurimit ka kërkuar që ofertuesi të paraqesë certifikatë ISO 9001:2008 origjinale, ose kopje e noteruar, por pa ekzistuar ndonjë lidhje midis ofertuesit dhe prodhuesit.

Certifikata origjinale ISO ... jepet vetëm njëherë (*një kopje*) me afat vlefshmërie disa vjet.

Në këtë situatë OE ofertues, natyrshëm kanë shkarkuar nga interneti certifikatat e kërkuar, të cilat dhe i kanë noteruar, por që në thelb, ashtu si i ka kërkuar njësia e prokurimit, pa lidhje midis ofertuesit dhe prodhuesit, nuk ka vlerë për AK, është kriter kualifikues i vendosur pa kuptim.

Në thelb vendosja e kriterëve të tilla, shoqëruar me një numër katalogësh të paraqitura nën autoritetin e prodhuesit etj, vetëm sa “*dekurajojnë*”, kufizojnë OE të marrin pjesë në tender (*në tenderët e përshkruar në katër prej tyre është paraqitur një ofertues, kurse në dy të tjerë janë paraqitur dy OE, njeri prej të cilëve është skualifikuar*).

Njësia e prokurimit është përgjegjëse gjithashtu, pasi në dokumentacionin e dërguar AK, nuk janë përfshirë dhe KVK, me qëllim që “*Komisioni i pritjes së mallit ...*” të AK, të kishte mundësinë gjatë marrjes në dorëzim të mallrave në zbatim të KVK:

- Të bënte krahasimin nëse artikujt e furnizuar janë të njëjtë me ata të parashikuara në ofertë dhe

- Nëse mallrat e furnizuara janë të shoqëruar me *certifikatën e cilësisë, origjinës... dhe fletën e garancisë* për artikujt objekt prokurimi.

Nga verifikimi i procedurës së ekzekutimit të kontratës për të katër tenderët, në dokumentacionin e paraqitur nga OE, u konstatuan të njëjtat parregullsi në plotësimin e KVK, të cilat janë pasojë e përcaktimit jo të saktë të tyre nga njësia e prokurimit.

OE fitues, në momentin e dorëzimit të mallit nuk kanë paraqitur *certifikatën e origjinës së mallit dhe fletën e garancisë...*, si dhe artikujt të furnizuar prej tyre, nuk janë të kompanive prodhuese të përcaktuara në ofertën e paraqitur nga OE fitues, në kundërshtim me KVK të përcaktuara.

Fakti se:

- pjesëmarrja e OE në tenderë është shumë e ulët (përgjithësisht një),

- tenderët fitohen me vlefte të plotë dhe

- fituesi është përgjithësisht i njëjti (*A...Co fitues në tre tenderë gjatë vitit 2014, fitues edhe në vitin 2013 etj.*), komprometon në tërësi procedurat e tenderëve të zhvilluar.

Gjithashtu J. K, me detyrë specialiste e SAP, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit/KVO pasi në tenderin me objekt:

“Rikonstruktion i pjesshëm ... në godinën e Ministrisë së Mbrojtjes”,

“Rikonstrukcioni i infrastrukturës së rrjeteve për MM”,

ka vendosur kriterë të gabuara që kanë ndikuar në zhvillimin e procedurës së tenderit dhe kualifikimin e OE si:

- Zgjedhja e procedurës “me negociim” është në kundërshtim me nenin 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006,-

- Vendosja numrit të punonjësve,

- Licencat e kërkuara etj.

- Nuk ka kërkuar që paraprakisht projekti rikonstruksionit etj, fillimi i procedurës së tenderit të kryhet, pasi Autoriteti kontraktor të jetë i pajisur me leje zhvillimi/ndërtimi në kundërshtim me nenin 15, 16 të VKM nr. 502, datë 13.7.2009 i ndryshuar.

- Ka lejuar që se procedura e tenderit me objekt “Blerje furnizim, instalim, vënia në punë e SIVHD ...” zhvilluar në vitin 2014, me vlerë të realizuar të kontratës rreth 85,000 mijë lekë, fituar me vlerë të plotë, të jetë zhvilluar “sekret” në nivelin e sigurisë “I kufizuar”, në mungesë të një dokumenti dalë në zbatim të nenit 6 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.

- ka gabuar në përzgjedhjen e OE që janë ftuar për të marrë pjesë në tender. OE të ftuar, qysh në momentin e përzgjedhjes dukshëm, nuk plotësojnë kriteret që ka kërkuar AK, çka komprometon garën prej nisjes, duke e paragjykuar atë OE fitues është shoqëri “pastrimi” dhe pas verifikimit të kualifikimit të tyre, rezulton se të gjithë punëtorët e OE fitues, janë “Fshesarë”.

Në thelb, me praktikën e ndjekur njësia e prokurimit, ka përgatitur kushte për të kualifikuar OE, pa besueshmëri e duhur për kryerjen e punimeve, në kundërshtim me nenin 2 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar.

28. Z. P. K, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit.

29. Z. N. R, në cilësinë kryetarit,

30. I. Ç,

31. B.M,

32. P. H,

33.V. C,

34. E.T, me detyrë përgjegjës materiali, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të pritjes së mallit të Repartit Ushtarak nr. 4002, pasi në tenderin me objekt *“Blerje pjesë këmbimi dhe materiale për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit” tre lote*, ka pranuar dhe marrë në dorëzim (janë bërë hyrje në magazinë) pjesët e ndërrimit etj, objekt tenderi, të pa shoqëruar me certifikatë origjinës së mallit dhe fletën e garancisë. Artikujt e furnizuar nuk janë të kompanive që ofertuesi fitues ka paraqitur në ofertë etj, në kundërshtim me:

- pikën 2.2.2./b të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit (KVK), në të cilën është përcaktuar se ... *për të gjithë artikujt objekt prokurimi, ose të grupuar sipas loteve apo sistemeve të ndryshme të pjesëve të këmbimit, ofertuesi duhet të deklarojë sipas pasqyrës së mëposhtme, kompaninë prodhuese, certifikatën ISO 9001:2008 të saj dhe me anë të kësaj deklarate të garantojë autoritetin kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim i së njëjtës kompani.*

- pikën 2.2.3. të KVK në të cilën është përcaktuar se ... *OE ... në momentin e dorëzimit, mallrat objekt prokurimi do të shoqërohen me certifikatën e origjinës së mallit dhe fletën e garancisë*

Të njëjtat parregullsi janë konstatuar edhe në tenderët me objekt:

- *“Blerje materiale teknike për anijet e klasit Iliria”* me fond limit 9,659,600 lekë dhe kontraktues OE “A.... Co” sh.p.k. me vlerë të kontratës së lidhur 11,377,800 lekë, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi njësia e prokurimit të përbërë nga G. J, E. T, R.R dhe Komisionin e pritjes së mallit të përbërë nga Major A. Z, kryetar, R. R, Kapiten K. T, Kapter H. B dhe F. Ç përgjegjës materiali, në cilësinë e anëtarëve.

- *“Blerje materiale Riparimi për flotën”* me fond limit 16,357,851 lekë dhe kontraktues BOE “H...” sh.p.k. & “A.... Co” sh.p.k. me fond limit 16,217,943 lekë dhe vlerë të kontratës 19,461,532 lekë, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi njësia e prokurimit të përbërë nga G. J, R. R dhe Komisionin e pritjes së mallit të përbërë nga Major A. Z, kryetar, D.L, K. K, I. V, civil dhe F. Ç.

- *“Blerje materiale për mirëmbajtjen e rrjetit të klasifikuar ...”*, me fond limit 24,333,3332

dhe kontraktues OE "J.... k... sistem" sh.p.k. me vlerë 26,399,998 lekë, të cilat ngarkojnë me përgjegjësi njësinë e prokurimit të përbërë nga G. J, E. B dhe Komisionin e pritjes së mallit të përbërë nga kapiten L. Kkapiten E. Q, toger A. Hi dhe reshter H.M, me detyrë përgjegjës materiali, të Repartit Ushtarak nr. 6640.

35. A. K, me detyrë sekretar i përgjithshëm në cilësinë e kryetarit të KVO,

36. E. T, në cilësinë e anëtarit,

37. F. H, në cilësinë e anëtarit të KVO në tenderin me objekt:

- *"Rikonstruksion i pjesshëm ... në godinën e Ministrisë së Mbrojtjes",*

- *"Rikonstruksioni i infrastrukturës së rrjeteve për MM",* me fond limit 38,632 mijë lekë pasi:

- kanë gabuar në përzgjedhjen e OE që janë ftuar për të marrë pjesë në tender. OE të ftuar, qysh në momentin e përzgjedhjes dukshëm, nuk plotësojnë kriteret që ka kërkuar AK, çka komprometon garën prej nisjes, duke e paragjykuar atë OE fitues është shoqëri *"pastrimi"* dhe pas verifikimit të kualifikimit të tyre, rezulton se të gjithë punëtorët e OE fitues, janë *"Fshesarë"*.

-kanë kualifikuar dhe shpallur fituesin në kundërshtim të ndjeshëm me kërkesat e përcaktuara në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST të miratuara.

38. Z. Q.Sh, gjeneral brigade, pasi:

- Ka urdhëruar rishikimin/ndryshimin në rritje të çmimit të dy artikujve *"Limiter ..."* dhe *"RF Sëitch..."* të tenderit me objekt *"Blerje furnizim, instalim, vënia në punë e SIVHD ..."* Kontratë shtesë" me fond limit 9,604,492 lekë, i cili është shoqëruar me dëm ekonomik në vlerën 755,586 lekë, në kundërshtim me:

- pikën 3 të nenit 35/1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, e cila përcakton se ... *Kur lidhen kontrata, të bazuara në një marrëveshje kuadër, palët nuk munden, në asnjë rrethanë, të bëjnë ndryshime thelbësore të kushteve të parashtruara në marrëveshjen kuadër ... dhe vet "Marrëveshjen kuadër" nr. 540/2, datë 18.12.2013 lidhur midis MM dhe dy OE "I... T..." sh.p.k. dhe "A... com..." sh.p.k, në të cilën ndër të tjera është përcaktuar se :*

- Në pjesën hyrëse të kësaj marrëveshje ... Kontraktuesi me anë të ofertës së tij në datë 18.12.2014 bie dakord të furnizojë mallrat ... si janë përcaktuar në këtë formular kontrate dhe formular i çmimit të ofertës,

- në pikën ... 1.1. Objekti i marrëveshjes kuadër është që të përcaktojë kushtet përfshirë çmimet për njësi...Ofertat ekonomike të paraqitura nga kontraktuesit dhe të pranuar nga AK janë pjesë e pandarë e kësaj marrëveshje kuadër etj.

- Në tenderin me objekt *"Blerje furnizim, instalim, vënia në punë e SIVHD ..."* me fond limit 63,019,515 lekë, ka pranuar/miratur shtyrjen e afatit kohor për zbatimin e kontratës nr. 382/4, datë 30.12.2013 ka qenë 45 ditë, ose 90 ditë kalendarike gjithsej, në kundërshtim me përcaktimet e përshkruara në kontratën lidhur midis palëve, pa zbatuar penalitet me vlerë të llogaritur prej 2,482,217 lekë ndaj OE.

39. Z. F. K, kapiten i rangut të II, për shkak se kanë urdhëruar rishikimin/ndryshimin në rritje të çmimit të dy artikujve *"Limiter ..."* dhe *"RF Sëitch..."* të tenderit me objekt *"Blerje furnizim, instalim, vënia në punë e SIVHD ..."* Kontratë shtesë" me fond limit 9,604,492 lekë, i cili është shoqëruar me dëm ekonomik në vlerën 755,586 lekë, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 35/1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, *"Marrëveshjen kuadër" nr. 540/2, datë 18.12.2013 lidhur midis MM dhe dy OE "I... T..." sh.p.k. dhe "A... com..." sh.p.k, etj.*

40. Z. G. V, me profesion inxhinier, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, pasi ka bërë ndryshimin e çmimit në rritje të artikullit Front &End, në tenderin me objekt *"Blerje furnizim, instalim, vënia në punë e SIVHD ..."* Kontratë shtesë" me fond limit 9,604,492

lekë, i cili është shoqëruar me dëm ekonomik me vlerë 948,672 lekë, në kundërshtim me pikën 3 të nenit 35/1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, “Marrëveshjen kuadër” nr. 540/2, datë 18.12.2013 lidhur midis MM dhe dy OE “I... T...” sh.p.k. dhe “A... com...” sh.p.k, etj

- Në tenderin me objekt “*Blerje furnizim, instalim, vënia në punë e SIVHD ...*” me fond limit 63,019,515 lekë, ka pranuar/miratuar shtyrjen e afatit kohor për zbatimin e kontratës nr. 382/4, datë 30.12.2013 ka qenë 45 ditë, ose 90 ditë kalendarike gjithsej, në kundërshtim me përcaktimet e përshkruara në kontratën lidhur midis palëve, pa zbatuar penalitetet me vlerë të llogaritur prej 2,482,217 lekë ndaj OE.

- Ka lejuar/pranuar zhvillimin e procedurës së tenderit “*Blerje furnizim, instalim, vënia në punë e SIVHD ...*” si i “klasifikuar” në nivelin e sigurisë “I kufizuar”, në mungesë të miratimi të tillë.

41. K. K,

42. L. K,

- Kanë lejuar/pranuar zhvillimin e procedurës së tenderit “*Blerje furnizim, instalim, vënia në punë e SIVHD ...*” si i “klasifikuar” në nivelin e sigurisë “I kufizuar”, në mungesë të miratimi të tillë.

E. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “*Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar neni 281, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, është sugjeruar trajtimi i detajuar tekniko juridik nga ana e Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit në kuptim të referencave të Kodit Penal, për personat si më poshtë:

1. Z. Ë. Ç, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme së Standarteve të NATO-s dhe Modernizimit,

2. Kapiten i Rangut të II A. Sh, me detyrë Shef i Sektorit të Hartimit të Projekteve, në cilësinë e kryetarit të grupit të punës për hartimin e projektit teknik.

3. N/kolonel M. K, me detyrë Shef Shtabi në Policinë Ushtarake dhe në cilësinë e anëtarit të grupit të punës.

4. Z. B.D, Kapiten, me detyrë shef logjistike në Policinë Ushtarake dhe në cilësinë e anëtarit të grupit të punës.

5. Z. B. B, Kapiten, me detyrë Komandat i Kompanisë operacionale në Policinë Ushtarake.

6. Z. N.G, në cilësinë e anëtarit të grupit të punës,

7. Z. E. D, në cilësinë e anëtarit të grupit të punës,

pasi:

Në tenderin me objekt “*Blerje mjete të blinduara për policinë ushtarake me kompaninë Iveco s.p.a,*” kanë rritur në mënyrë të pajustificuar, fondin limit nga 1,200,000 Euro të parashikuar në projektin fillestar të propozuar nga Komanda e Policisë Ushtarake, në 1,420,000 Euro, ose 220,000 euro më shumë.

8. Kolonel M. M, me detyrë Z/V Komandant i KFA,

9. N/Kolonel O. N, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës së KFA,

10. Kolonel S.Ç, me detyrë ish Komandant i Repartit Ushtarak nr. 3006,

11. N/Kolonel A. L, me detyrë ish Komandant i Repartit Ushtarak nr. 3006,

12. Kolonel K. H, me detyrë Komandantë të Repartit Ushtarak nr. 3006,

13. Zj. L. A, me detyrë ish Shefe e Financës e Repartit 3006,

pasi:

Gjatë zbatimit të kontratës së tenderit me objekt “*Furnizimi me 5 helikopterë të mesëm shumërolësh*” e ndryshuar, nëpërmjet veprimeve të kryera prej tyre, kompanisë “E.....” i janë likuiduar katër kite me vlerë 3,458,142 euro, ose 639,794 euro më shumë ndërkohë që vlera e katër kiteve sipas dokumentacionit të bërë hyrje është 2,764,348 euro.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Fatmir Zilja, përgjegjës grupi, Selime Bregu, Valentina Golemi dhe Dritan Kore, më tej materiali u shqyrtua nga Kryeaudituesi, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Zbatimit të Standardeve, Drejtori i Departamentit dhe Drejtori i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT